REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2777/1 prot. Tiranë, më 26.10.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj nr. 5555/1 prot., datë 02.10.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", së bashku me relacionin shoqërues.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së tij, vlerëson se disa prej dispozitave të propozuara lidhen drejtpërdrejt me fushat e saj të veprimtarisë, konkretisht me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për informim, të rregulluara përkatësisht nga ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "ligji nr.124/2024") dhe ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 119/2014").

Pa cenuar natyrën e posaçme të procedimit penal dhe kompetencat e organeve proceduese, Zyra e Komisionerit vlerëson se dispozitat e projektligjit që prekin këto dy fusha kërkojnë, në disa aspekte, saktësim dhe harmonizim me kuadrin ligjor përkatës. Për këtë qëllim, paraqesim komentet dhe rekomandimet e mëposhtme.

I. Vlerësime lidhur me të drejtën për informim

Zyra e Komisionerit vlerëson se projektligji synon forcimin e garancive për mbrojtjen e sekretit hetimor, të drejtave të personave të përfshirë në procedimin penal dhe parimit të prezumimit të pafajësisë. Këto përbëjnë interesa të ligjshme, mbrojtja e të cilave duhet të garantohet në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

Megjithatë, duke qenë se disa prej ndryshimeve të propozuara ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin në informacion dhe publikimin e dokumenteve zyrtare, vlerësohet i nevojshëm harmonizimi i tyre me ligjin nr. 119/2014, si dhe me Konventën e Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (Konventa e Tromsos), e ratifikuar me ligjin

nr.45/2022. Në këtë kuadër, kufizimet e së drejtës për informim duhet të jenë të përcaktuara qartë dhe të zbatohen në përputhje me kërkesat e domosdoshmërisë dhe të proporcionalitetit, duke marrë në konsideratë dëmin që mund të shkaktojë dhënia e informacionit dhe ekzistencën e një interesi publik më të lartë për informim.

Në lidhje me ndryshimet e propozuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, shqetësim paraqet parashikimi, sipas të cilit, në rast refuzimi të kërkesës për informacion nga personat e tretë, ankimi ushtrohet vetëm në rrugë gjyqësore, duke përjashtuar ankimin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Ky formulim kërkon saktësim, pasi nuk dallon qartë kërkesat për njohjen me aktet e procedimit penal, të cilat mund t'i nënshtrohen një regjimi të posaçëm procedural, nga kërkesat për informacion publik me karakter administrativ, statistikor ose institucional që disponohet nga organet e prokurorisë. Në mungesë të këtij dallimi, dispozita mund të interpretohet si përjashtim i përgjithshëm i kompetencave të Komisionerit edhe për kërkesat që trajtohen sipas legjislacionit për të drejtën e informimit.

Për këtë arsye, sugjerohet të përcaktohet qartë fusha e zbatimit të mekanizmit të posaçëm të ankimit gjyqësor, duke shmangur kufizimin e panevojshëm të kompetencave të Komisionerit, të parashikuara në nenet 9/1 dhe 24 të ligjit nr. 119/2014.

Ky vlerësim mbështetet edhe në Raportin e Vlerësimit Bazë për Shqipërinë, të publikuar më 11 mars 2025 nga Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (AIG), i cili vlerëson përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar për të drejtën e informimit me parimet dhe kërkesat e Konventës së Tromsos. Në këtë kontekst, një përjashtim i përgjithshëm i mekanizmit ekzistues të ankimit administrativ duhet të vlerësohet me kujdes, në mënyrë që të mos cenohen garancitë e aksesit në informacion.

Gjithashtu, referimi te "*interesi i kërkuesit për informim*" kërkon rishikim, pasi neni 3 i ligjit nr. 119/2014 dhe neni 4 i Konventës së Tromsos garantojnë të drejtën e aksesit në informacionin publik pa detyrimin për të shpjeguar motivet e kërkesës. Për rrjedhojë, në rastet që trajtohen sipas legjislacionit për të drejtën e informimit, vlerësimi duhet të përqendrohet te nevoja për mbrojtjen e sekretit hetimor, dëmi që mund të shkaktojë dhënia e informacionit dhe balancimi i interesave në përputhje me ligjin.

Sa i përket kufizimeve të publikimit të akteve pas përfundimit të sekretit hetimor, përfshirë vendimet gjyqësore për masat e sigurimit, si dhe ndryshimeve të propozuara në nenin 279 të Kodit të Procedurës Penale, vlerësohet e nevojshme të përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre. Në veçanti, duhet të qartësohet marrëdhënia ndërmjet detyrimit të ri për mospublikim dhe kompetencës ekzistuese të prokurorit për të kufizuar publikimin e akteve të veçanta me vendim të arsyetuar, me qëllim shmangien e interpretimeve që mund të sjellin kufizime të përgjithshme dhe të pajustifikuara të aksesit në informacion.

Po kështu, kushti i pëlqimit të të pandehurit për publikimin e akteve duhet të përcaktohet më qartë, duke vlerësuar fushën e zbatimit të tij dhe raportin me rastet kur publikimi mund të justifikohet nga një interes publik më i lartë, në përputhje me kufizimet dhe garancitë

ligjore përkatëse. Gjithashtu, përgjegjësia për shkeljen e rregullave të sekretit dhe të ndalimit të publikimit duhet të harmonizohet me nenin 104 të Kodit të Procedurës Penale, për të shmangur mbivendosjet normative.

Në lidhje me ndryshimet që prekin publikimin e rezultateve të përgjimeve parandaluese dhe shtimin e nenit 308/a të Kodit të Procedurës Penale, Zyra e Komisionerit vlerëson se mbrojtja e sigurisë kombëtare, sekretit hetimor, jetës private dhe prezumimit të pafajësisë përbëjnë një qëllim të ligjshëm. Megjithatë, formulimet kategorike ose të gjera të dispozitave duhet të saktësohen, në mënyrë që ndalimi i publikimit të rezultateve të përgjimeve dhe i të dhënave që identifikojnë personat nën hetim të mos interpretohet si përjashtim i përgjithshëm nga e drejta për informim. Zbatimi i këtyre kufizimeve duhet të ruajë mundësinë e aksesit në informacionin tjetër publik që nuk zbulon përmbajtjen ose rezultatet e përgjimeve, nuk cenon sekretin hetimor dhe nuk prek interesa të tjera të mbrojtura me ligj.

Në këtë drejtim, anonimizimi dhe redaktimi i dokumenteve duhet të mundësojnë mbrojtjen e interesave të ligjshëm, duke ruajtur aksesin në pjesën tjetër të dokumentit, në përputhje me nenin 17, pika 6, të ligjit nr. 119/2014 dhe nenin 6, pika 2, të Konventës së Tromsos.

II. Vlerësime lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale

Zyra e Komisionerit vlerëson se ndryshimet e propozuara në Kodin e Procedurës Penale duhet të analizohen edhe në raport me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e një ekuilibri të përshtatshëm ndërmjet efektivitetit të procedimit penal dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Në këtë drejtim, referuar ligjit nr. 124/2024, veçanërisht dispozitave që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit dhe ndjekjes penale, si dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësohet se projektligji duhet të garantojë që çdo ndërhyrje në të dhënat personale të mbështetet në ligj, të ndjekë një qëllim të përcaktuar dhe të jetë e nevojshme e proporcionale me qëllimin e ndjekur.

Në lidhje me **nenin 10 të projektligjit**, i cili ndryshon nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale dhe parashikon anonimizimin dhe redaktimin e dokumenteve në rastet kur publikimi i tyre lejohet, sugjerohet të saktësohet se anonimizimi duhet të kryhet në mënyrë të tillë që personi të mos jetë i identifikueshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke marrë në konsideratë edhe informacionin tjetër të disponueshëm që mund të mundësojë identifikimin e tij.

Në lidhje me dispozitat që rregullojnë provat digjitale, vlerësohet se parashikimet për kërkimin, marrjen, sekuestrimin, kopjimin dhe shqyrtimin e të dhënave elektronike duhet të plotësohen me garanci të qarta për mbrojtjen e të dhënave personale. Duke qenë se pajisjet elektronike dhe sistemet informatike mund të përmbajnë sasi të konsiderueshme informacioni personal, përfshirë të dhëna të personave të tretë që nuk kanë lidhje me

procedimin penal, sugjerohet që përpunimi të kufizohet në të dhënat e nevojshme dhe të lidhura me objektin e procedimit.

Për këtë qëllim, propozohet që **neni 21 i projektligjit**, i cili shton nenin 152 në Kodin e Procedurës Penale, të plotësohet me parashikimin e mëposhtëm:

"Gjatë kërkimit, sekuestrimit, kopjimit, marrjes dhe shqyrtimit të të dhënave elektronike, organi procedues siguron që përpunimi i të dhënave personale të kufizohet në ato të dhëna që janë të nevojshme dhe të lidhura me qëllimin e veprimit procedural. Kur pajisjet ose sistemet elektronike përmbajnë të dhëna personale të personave të tretë që nuk lidhen me objektin e procedimit, merren masa të përshtatshme për kufizimin e aksesit dhe të shqyrtimit të tyre, pa cenuar ruajtjen e integritetit të provës dhe efektivitetin e hetimit".

Ky plotësim synon të garantojë zbatimin e parimeve të minimizimit të të dhënave dhe të kufizimit të qëllimit të përpunimit, pa cenuar ushtrimin e kompetencave ligjore të organeve proceduese.

Lidhur me regjistrimin, administrimin dhe përdorimin e të dhënave personale gjatë procedimit penal, sugjerohet të garantohet dallimi i qartë ndërmjet kategorive të personave, në varësi të statusit të tyre procedural. Në përputhje me nenin 49 të ligjit nr.124/2024, përpunimi i të dhënave për qëllime penale duhet të marrë në konsideratë dallimin ndërmjet personave të dyshuar, personave të dënuar, viktimave dhe kategorive të tjera përkatëse. Për këtë arsye, propozohet që dispozitat përkatëse të plotësohen me parashikimin e mëposhtëm:

"Gjatë regjistrimit, administrimit dhe përdorimit të të dhënave personale në kuadër të procedimit penal, organet kompetente sigurojnë, për aq sa është e mundur, dallimin ndërmjet kategorive të personave sipas statusit të tyre procedural. Të dhënat duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara, ndërsa pasaktësitë ose ndryshimet në statusin procedural trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi".

Ky parashikim synon të parandalojë pasaktësitë në administrimin e informacionit dhe trajtimin e papërshtatshëm të personave, për shkak të të dhënave të pasakta ose të papërditësuara.

Në lidhje me **nenin 29 të projektligjit**, i cili parashikon shtesa dhe ndryshime në nenin 207 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht në pikën 2 të nenit 207/a, ku përcaktohet se prokurori mund të kërkojë marrjen e kampionëve biologjikë për përcaktimin e profilit të ADN-së, pasi merr pëlqimin e të pandehurit ose të personave të tjerë, vlerësohet se duhet të qartësohen kriteret ligjore për përpunimin e këtyre të dhënave.

Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit thekson se përpunimi i të dhënave sensitive, përfshirë të dhënat gjenetike të përftuara nga kampionët biologjikë, duhet të kryhet në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 124/2024, i cili parashikon se ky përpunim lejohet vetëm kur është absolutisht i nevojshëm, zbatohen masa të përshtatshme mbrojtëse për të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave dhe përmbushen kushtet e tjera të përcaktuara në këtë dispozitë. Për rrjedhojë, sugjerohet që dispozita të përcaktojë qartë

kushtet dhe garancitë ligjore për përpunimin e këtyre të dhënave, në përputhje me kërkesat e nenit 52 të ligjit nr. 124/2024.

Lidhur me **nenin 30 të projektligjit**, i cili përcakton afatet e ruajtjes dhe rastet e asgjësimit të kampionëve biologjikë, vërehet se nuk rregullohet në mënyrë të plotë ruajtja dhe fshirja e profileve të ADN-së të përftuara nga analizimi i tyre. Në veçanti, në rastet kur ndaj të pandehurit është dhënë vendim pafajësie i formës së prerë, parashikohet asgjësimi i kampionit biologjik, pa u përcaktuar shprehimisht trajtimi i profilit të ADN-së së përftuar prej tij. Për këtë arsye, sugjerohet plotësimi i dispozitës me rregulla të qarta për ruajtjen, fshirjen dhe, sipas rastit, asgjësimin e profileve të ADN-së, në përputhje me qëllimin e përpunimit dhe kriteret ligjore përkatëse.

Në lidhje me **nenin 94 të projektligjit**, i cili parashikon mundësinë e transmetimit të drejtpërdrejtë *online* të seancës gjyqësore, vlerësohet se, krahas garancive për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe personave të tretë, duhet të parashikohen masa të përshtatshme për kufizimin e ekspozimit të të dhënave personale gjatë transmetimit. Duke pasur parasysh se transmetimi *online* mundëson përhapjen e gjerë të informacionit për personat e përfshirë në proces, sugjerohet të parashikohet mundësia e kufizimit ose e maskimit të pamjes, zërit dhe elementeve të tjera identifikuese, kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e jetës private dhe të drejtave të tyre, pa cenuar parimet e publicitetit të gjykimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimet e projektligjit për forcimin e garancive të procedimit penal, mbrojtjen e sekretit hetimor dhe respektimin e të drejtave të personave të përfshira në të janë të ligjshme. Megjithatë, përmbushja e këtyre qëllimeve duhet të shoqërohet me garanci të qarta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të së drejtës për informim, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

Për rrjedhojë, sugjerohet që gjatë rishikimit dhe finalizimit të projektligjit të merren në konsideratë komentet dhe rekomandimet e mësipërme, me qëllim saktësimin e dispozitave që rregullojnë aksesin dhe publikimin e informacionit, mekanizmat e ankimit, përpunimin e të dhënave personale dhe garancitë për mbrojtjen e tyre. Në veçanti, vlerësohet e nevojshme të shmangen kufizimet e përgjithshme dhe joproporcionale të së drejtës për informim, të ruhen kompetencat e Komisionerit sipas ligjit nr. 119/2014 dhe të parashikohen garanci të përshtatshme për ligjshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr.124/2024.

Zyra e Komisionerit mbetet e gatshme të kontribuojë, brenda fushës së kompetencave të saj, në procesin e mëtejshëm të shqyrtimit të projektligjit, me qëllim garantimin e një kuadri ligjor koherent dhe të harmonizuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi